



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.24

10 mars

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.135, datë 11.2.2009	Për mbylljen e Akademisë së Policisë “Arben Zylyftari” dhe riorganizimin e arsimimit policor si pjesë përbërëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit	1453
Vendim i KM nr.136, datë 11.2.2009	Për miratimin e uniformës, të formës dhe elementeve të gradave e të shenjave dalluese të efektivave të Gardës së Republikës së Shqipërisë	1453
Vendim i KM nr.137, datë 11.2.2009	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni i rrugës “Skënderbeg”, në bashkinë e Shkodrës	1462
Vendim i KM nr.138, datë 11.2.2009	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni i rrugës “Isuf Sokoli”, në bashkinë e Shkodrës	1465
Vendim i KM nr.139, datë 11.2.2009	Për një shtesë në vendimin nr.478, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të ministrave të linjës”, të ndryshuar	1467
Vendim i KM nr.140, datë 11.2.2009	Për disa ndryshime në vendimin nr.624, datë 21.12.1999 të Këshillit të Ministrave “Për përballimin e shpenzimeve të palës shqiptare, pjesëmarrëse në forcën shumëkombëshe të Europës Juglindore, dhe të drejtat e ushtarakëve aktivë, pjesëmarrës në këtë forcë”, të ndryshuar	1468
Vendim i KM nr.144, datë 11.2.2009	Për miratimin e formularëve të vetëdeklarimit, për të ushtruar veprimtarinë e tregtimit me shumicë të barnave, të tregtimit në farmaci dhe agjenci farmaceutike, si dhe të import-eksportit të tyre	1468

Vendim i KM nr.146, datë 11.2.2009	Për një rishpërndarje fondesh buxhetore, të miratuara për vitin 2009, për Ministrinë e Brendshme, brenda programeve buxhetore të kësaj ministrie	1473
Vendim i KM nr.147, datë 11.2.2009	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të kaskadës së hidrocentraleve në lumin Fan i Vogël, dhe për miratimin e bonusit, në procedurën për zgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	1473
Vendim i KM nr.150, datë 11.2.2009	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.917, datë 29.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrëshen-Kalimash”	1474
Vendim i KM nr.151, datë 11.2.2009	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrëshen-Kalimash	1477
Vendim i KM nr.154, datë 11.2.2009	Për një ndryshim në vendimin nr.486, datë 25.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për ndërprerjen e veprimtarisë së përpunimit të anijeve, që transportojnë naftë, gaz dhe nënprodukte të tyre, në portet e Durrësit dhe të Shëngjinit”	1478
Vendim i KM nr.155, datë 11.2.2009	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të ndërtimit të portit të jahteve në kepin e Rodonit, gjiri i Lalzit, Durrës, dhe për miratimin e bonusit, në procedurën për zgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	1479
Vendim i KM nr.156, datë 11.2.2009	Për disa shtesa në vendimin nr.78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e maturës shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, të ndryshuar	1479
Vendim i KM nr.165, datë 11.2.2009	Për disa shtesa në vendimin nr.335, datë 2.9.1997 të Këshillit të Ministrave “Për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit”, të ndryshuar.....	1480

VENDIM
Nr.135, datë 11.2.2009

**PËR MBYLLJEN E AKADEMISË SË POLICISË “ARBEN ZYLYFTARI” DHE
RIORGANIZIMIN E ARSIMIMIT POLICOR SI PJESË PËRBËRËSE E DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 41 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbylljen e Akademisë së Policisë “Arben Zylyftari”, si institucion i arsimit të lartë, për shkollimin e punonjësve të Policisë së Shtetit, dhe riorganizimin e arsimit policor si pjesë përbërëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

2. Arsimimi policor të riorganizohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në përputhje me ligjin nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”.

3. Vendimi nr.281, datë 2.6.2000 i Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Policisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

4. Ngarkohet Ministri i Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.136, datë 11.2.2009

**PËR MIRATIMIN E UNIFORMËS, TË FORMËS DHE ELEMENTEVE TË GRADAVE E TË
SHENJAVE DALLUESE TË EFEKTIVAVE TË GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr.8869, datë 22.5.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 25 të ligjit nr.9366, datë 31.3.2005 “Për gradat dhe karrierën në Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Uniforma, forma dhe elementet e gradave dhe të shenjave dalluese të efektivave të Gardës së Republikës së Shqipërisë të jenë sipas modeleve dhe specifikimeve teknike, të paraqitura, përkatësisht, në lidhjen nr.1 e në lidhjen nr.2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Uniformat për efektivat e Gardës së Republikës së Shqipërisë të jenë:

a) Uniforma e oficerit dhe e nënoficerit;

b) Uniforma për shërbim e stërvitje;

c) Uniforma ceremoniale;

ç) Uniforma e trupprojës së nderit;

d) Uniforma civile.

3. Ministri i Brendshëm miraton:

a) Rregulloren e uniformës së Gardës.

- b) Normën e materialeve të veshmbathjes, në përbërje dhe në inventar të strukturave të Gardës.
- c) Normën e furnizimit me veshmbathje për efektivat e Gardës.
- ç) Normën e furnizimit me veshje civile ose konvertimin e saj në vlerë (në lekë).
- d) Normën e materialeve të konsumit dhe të mirëmbajtjes.
- dh) Normën e veshmbathjes së posaçme të shërbimit civil, sipas profesioneve.
- e) Normën e pajisjeve për qentë, në organikë të Gardës.
- ë) Uniformën për shërbime të veçanta: për shërbimin e trupave speciale, me motoçikletë, me helikopter dhe me mjete lundruese, si dhe elementet speciale të tyre.
- f) Zëvendësimet e materialeve të veshmbathjes, brenda vlerës së normës.
- g) Ndryshimet e mundshme në elemente të veçanta të uniformës, të elementeve të gradave dhe shenjave dalluese, sipas ndryshimeve, që mund të ndodhin në strukturën e Gardës së Republikës së Shqipërisë.

4. Vendimi nr.511, datë 9.11.1999 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e uniformës të truporës së nderit dhe të stemës së Gardës së Republikës” dhe vendimi nr.67, datë 22.1.2004 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e uniformës dhe të shenjave dalluese të Gardës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, shfuqizohen.

5. Ngarkohen Ministri i Brendshëm dhe komandanti i Gardës së Republikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.2

SPECIFIKIMET TEKNIKE

TË UMFORMËS, FORMËS DHE ELEMENTEVE TË GRADAVE DHE SHENJAVE DALLUESE TË EFEKTIVAVE TË GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

1. UNIFORMA PËR TRUPROJËN E NDERIT

Kjo uniformë do të jetë verore dhe dimërore.

Uniforma verore përbëhet nga:

Kostumi (1 kapelë, 1 xhakëtë, 1 palë pantallona), shirit dekorativ (fjongo), doreza të bardha, këpucë gjysma të zeza, rrip mesi ceremonial, rrip pantalloni.

Xhaketa do të jetë dopjopet, prej stofi terital veror, me ngjyrë të kuqe, me përzierje 70% lesh, 30% poliestër +/- 5 %, masa 205 +/- 5 gr/m². Xhaketa është me jakë të zezë të mbyllur, e cila në anësore përshkohet nga një shirit me ngjyrë të kuqe 3-4 mm. Jaka, në gjithë gjatësinë e saj, është e qëndisur me fije ngjyrë ari, me gjethe në formë kurore, që fillojnë nga përpara e bashkohen në mesin e jakës prapa. Xhaketa përpara mbyllet me 9 çifte kopsash të mëdha garde. Xhaketa tek supet ka dy spaleta pllake me ngjyrë të artë, në pjesën e përparme të mëngëve është qëndisur me fill të zi shqiponja, në mesin e së cilës është qëndisur me fill ngjyrë ari përkrenaria e Skënderbeut.

Pantallonat janë stof teritali veror, me ngjyrë të zezë, me përzierje 70% lesh, 30% poliestër +/- 5 %, masa 205 +/- 5 gr/m². Kanë dy xhepa të pjerrët në anësore, në përparëse kanë dy pensa nga jashtë, në pjesën e prapme djathtas kanë një xhep të brendshëm me fileto që mbyllet me kopsë. Pantallonat, në dy anësoret në bashkimin e përparësve me pjesën e prapme të tyre, përshkohet nga shirit i kuq 3-4 mm, nga

qemerit deri në fund të pantallonave.

Kapela është stof teritali veror, me ngjyrë të zezë, me përzierje 70% lesh, 30% poliestër +/- 5 %, masa 205 +/- 5 gr/m². Ka strehë plastike me ngjyrë të zezë, streha plastike është e veshur me materialin si të kapelës në të cilën montohet në pjesën e përparme, në gjithë gjatësinë e saj një dekoracion me gjethe lisi të punuar me fije me ngjyrë të artë. Kapela, në bashkimin e tepelekut me rrethin, përshkohet nga një shirit i kuq 3-4 mm.

Shiriti dekorativ (fjongo) është prej pambuku-poliester i thurur me dy kordonë, me ngjyrë ari, vendoset në krahun e majtë nën spalinë, i varur poshtë në gjithë gjatësinë e tij dhe kapet me anë të një kapseje në nivelin e kopsës së dytë të xhakëtës.

Dorezat ceremoniale janë prej materiali pambuku, me ngjyrë të bardhë.

Rripi ceremonial është material sintetik me ngjyrë të artë, mbërthehet me anë të një togze me të njëjtën ngjyrë, e cila ka të stampuar në qendër shqiponjën e famurit kombëtar.

Uniforma dimërore përbëhet nga:

Kostumi (1 kapelë, 1 xhakëtë, 1 palë pantallona), shirit dekorativ (fjongo), doreza të bardha, këpucë gjysma të zeza, rrip ceremonial, rrip pantallonash.

Xhaketa do të jetë dopjopetë prej stofi leshi dimëror, me ngjyrë të kuqe, me përzierje 70% lesh, 30% poliestër +/- 5%, masa 280 +/- 8 gr/m². Xhaketa është me jakë të zezë të mbyllur, e cila në anësore përshkohet nga një shirit me ngjyrë të kuqe 3-4 mm. Jaka në gjithë gjatësinë e saj, është e qëndisur me fije ngjyrë ari, me gjethe në formë kurore, që fillojnë nga përpara e bashkohen në mesin e jakës prapa. Xhaketa përpara mbyllet me 9 çifte kopsash të mëdha garde. Xhaketa tek supet ka dy spaleta pllake me ngjyrë të artë, në pjesën e përparme të mëngëve është qëndisur me fill të zi shqiponja, në mesin e së cilës është qëndisur me fill ngjyrë ari përkrenarja e Skënderbeut.

Pantallonat janë stof leshi dimëror, me ngjyrë të zezë, me përzierje 70% lesh, 30% poliestër +/- 5%, masa 280 +/- 8 gr/m². Kanë dy xhepa të pjerrët në anësore, në përparëse kanë dy pensa nga jashtë, në pjesën e prapme djathtas kanë një xhep të brendshëm me fileto që mbyllet me kopsë. Pantallont në dy anësoret, në bashkimin e përparësve me pjesën e prapme të tyre, përshkohen nga shiriti i kuq 3-4 mm, nga qemerit deri në fund të pantallonit.

Kapela është stof leshi dimëror, me ngjyrë të zezë, me përzierje 70% lesh, 30% poliestër +/- 5%, masa 280 +/- 8 gr/m². Ka strehë plastike me ngjyrë të zezë, streha plastike është e veshur me materialin si të kapelës, në të cilën montohet në pjesën e përparme, në gjithë gjatësinë e saj, një dekoracion me gjethe lisi të punuar me fije me ngjyrë të artë.

Shiriti dekorativ (fjongo) është prej filli pambuk-poliester, i thurur, me dy kordonë, ngjyrë ari, vendoset në krahun e majtë nën spalinë, i varur poshtë në gjithë gjatësinë e tij dhe kapet me anë të një kapse në nivelin e kopsës së dytë të xhakëtës. Kapela, në bashkimin e tepelekut me rrethin, përshkohet nga një shirit i kuq 3-4 mm.

Dorezat ceremoniale janë prej lëkure shevro keci, me ngjyrë të bardhë.

Rripi ceremonial është material sintetik me ngjyrë të artë, mbërthehet me anë të një togze me të njëjtën ngjyrë e cila ka të stampuar në qendër shqiponjën e flamurit kombëtar.

2. UNIFORMA CEREMONIALE (për efektivat: oficerë dhe nënoficerë)

Kostum ceremonial (1 kapelë, 1 xhakëtë, 1 palë pantallona).

Xhaketa do të jetë e hapur monopet prej stofi me përzierje 70% lesh, 30% poliestër +/- 5%, me ngjyrë të zezë, masa 240 +/- 8 gr/m². Xhaketa përpara mbyllet me 4 kopsa të mëdha garde. Ka katër xhepa pllakë me kapak që mbyllet me kopsa të vogla garde, dy në pjesën e gjoksit dhe dy poshtë në përparëse. Mëngët, 10 cm nga buzët e tyre, përshkohen nga një shirit teritali i kuq 3-4 mm.

Pantallonat, prej stofi me përzierje 70% lesh, 30% poliestër +/- 5%, me ngjyrë të zezë (prej materiali të njëjtë me xhakëtën), kanë dy xhepa të pjerrët në anësore, në përparëse kanë dy pensa nga

jashtë, në pjesën e prapme djathtas kanë një xhep të brendshëm me kapak që mbyllet me kopsë. Pantallonat, në dy anësoret në bashkimin e përparseve me pjesën e prapme të tyre, përshkohen nga shirit i kuq 3-4 mm, nga qemeri deri në fund të pantallonit.

Kapela, prej stofi me përzierje 70% lesh, 30% poliestër +/- 5%, me ngjyrë të zezë (prej materiali të njëjtë me xhaketen dhe pantallonat). Ka strehë plastike me ngjyrë të zezë, në të cilën montohet në pjesën e përparme në gjithë gjatësinë e saj:

- Dy shirita në formë gjetheje lisi, e punuar me fije me ngjyrë ari për gradën madhore. (Gjeneral).

- Një shirit në formë gjetheje lisi, e punuar me fije me ngjyrë ari për gradat e larta. (Major-Kolonel)

- Streha e kapelës për gradat e ulëta, të mesme dhe për nënoficerët, nuk ka dekoracion kapela.

Shiriti dekorativ (fjongo) është prej filli pambuk-poliester, i thurur me ngjyrë ari, vendoset në krahun e majtë nën spalinë e varur poshtë në gjithë gjatësinë e tij dhe kapet në kopsën e parë të xhaketes.

Shiriti për gradën madhore "Gjeneral" është me tri kordona, për gradën e lartë "Kolonel" me dy kordona, gradat e tjera nuk kanë shirit dekorativ.

3. UNIFORMA E OFICERIT DHE E NËNOFICERIT TË GARDËS

Kostum (2 kapela, 1 xhakete, 2 palë pantallona për efektiv oficer e nënoficer, 1 palë pantallona dhe 1 fund për efektiv oficer e nënoficer)

Xhaketa do të jetë e hapur monopet, prej stofi, me përzierje 70% lesh, 30% poliestër +/- 5%, me ngjyrë të zezë, masa $240 \pm 8 \text{ gr/m}^2$. Xhaketa përpara mbyllet me 4 kopsa të mëdha garde. Ka katër xhepa pllakë me kapak që mbyllet me kopsa të vogla garde, dy në pjesën e gjoksit dhe dy poshtë në përparëse. Mëngët, 10 cm nga buzët e tyre, përshkohen nga një shirit teritali i kuq 3-4 mm.

Pantallonat, prej stofi me përzierje 70% lesh, 30% polyester +/- 5%, me ngjyrë të zezë, masa $240 \pm 8 \text{ gr/m}^2$ (prej të njëjtit stof si xhaketa), kanë dy xhepa të pjerrët në anësore, në përparëse kanë dy pensa nga jashtë, në pjesën e prapme djathtas ka një xhep të brendshëm me kapak që mbyllet me kopsë. Pantallonat në dy anësoret në bashkimin e përparësve me pjesën e prapme të tyre, përshkohen nga shirit i kuq 3-4 mm, nga qemeri deri në fund të pantallonave.

Fund për efektiv oficer. Fundi prej stofi me përzierje 70% lesh, 30% poliester +/- 5%, me ngjyrë të zezë, masa $240 \pm 8 \text{ gr/m}^2$ (prej të njëjtit stof si xhaketa), me qemer prej stofi. Gjatësia 2-3 cm poshtë gjurit, i drejtë dhe me një të çarë nga prapa. Fundi në dy anësoret, në bashkimin e përparësve me pjesën e prapme, përshkohet nga një shirit i kuq 3-4 mm, nga qemeri deri në fund të tij.

Kapela prej stofi me përzierje 70% lesh, 30% poliestër +/- 5%, me ngjyrë të zezë, masa $240 \pm 8 \text{ gr/m}^2$ (prej të njëjtit stof si xhaketa e pantallonat). Ka strehë plastike (për oficer, nënoficer) me ngjyrë të zezë. Për gradën madhore "Gjeneral", strehës plastike i montohen në pjesën e përparme në gjithë gjatësinë e saj dy shirita në formë gjetheje lisi të punuar me fije me ngjyrë ari dhe për gradat e larta (Major-Kolonel) një shirit në formë gjetheje lisi të punuar me fije ngjyrë ari. Kapela, në bashkimin e tepelekut me rrethin, përshkohet nga një shirit i kuq 3-4 mm.

Pardesy do të jetë e hapur monopet, prej stof leshi dimëror me ngjyrë të zezë, me përbërje 70% lesh, 30% poliestër +/- 5%, masa $280 \pm 8 \text{ gr/m}^2$. Ka 2 xhepa oblik në përparëse dhe nga një spalinë tek mëngët që kapet me kopsë. Rripi është prej të njëjtit material, i cili mbërthehet me togëz.

Xhakovento është prej stofi teritali me përbërje 50% lesh, 50% poliestër +/- 5%, me ngjyrë të zezë, masa $240 \pm 8 \text{ gr/m}^2$. Xhakoventoja është e hapur përpara, mbërthehet me kopsa dhe me zinxhirë në sallki. Xhakoventës, në fund, tek jaka dhe mëngët, i vendoset llantik akreliku me ngjyrë të zezë. Në supe ka spalina prej të njëjtit material.

Pulovra është prej materiali trikotazh i zi, përbërja 50 % lesh me 50 % akrelik +/- 5%, thurja llantik 2+2. Jaka në formë "V", ka dy spalina me fortesë të kollarisura.

Xhup $\frac{3}{4}$ sintetik, materiali pëlhurë impermeable (tekstil i gomuar), ngjyrë e zezë 100 % poliamid, masa $200 \pm 8 \text{ gr/m}^2$. Xhupi në pjesën e përparme mbyllet me 5 kopsa në sallki. Dy përparëset në pjesën e poshtme kanë nga një xhep të pjerrët. Në pjesën e gjoksit deri në pjesën e sipërme të xhepave të poshtëm

qepen dy xhepa të drejtë. Xhupi në anën e brendshme ka një veshje të ngrohtë, vatinë të thurur në dy krahët me astar ngjyrë të zezë. Xhupi bëhet me kapuç prej të njëjtit material. Në supe vendosen spalinat.

Këmishë me mëngë të gjata. Materiali pupilnë e bardhë me përzierje 80% pambuk. 20% poliestër +/-3%, masa 104 +/-3 gr/m². Këmisha është me jakë me kollaritje të plotë, ka dy xhepa përpara. Mëngët e gjata bëhen me kapakë me kollaritje. Këmisha përpara mbyllet me kopsa të vogla me ngjyrë të bardhë dhe të shndritshme.

Këmishë vere me mëngë të shkurta. Materiali puplinë bezhë e mbyllur, me përzierje 65% pambuk, 35% poliestër +/- 3%, masa 125 +/-3 gr/m² me jakë me kollaritje. Këmisha përpara mbyllet me kopsa të vogla me ngjyrë të njëjtë me atë të puplinës. Në fund këmisha ka një bordurë me gjërësi 5-6 cm, së cilës në të dy anët i vendoset llastik dhe mbyllet me dy kopsa. Këmishat kanë dy xhepa përpara me kapak. Xhepat janë me bordurë 3 +/- 0.2 cm në mes. Ka dy spalina me fortesë dhe kollaritje.

Kravata është material terital me ngjyrë të zezë.

Pantallona vere. Materiali me ngjyrë të zezë, me përzierje 30% viskozë dhe 70% poliestër +/-5 %, masa 180 +/-3 gr/m². Pantallonat e drejta kanë dy pensa nga jashtë përpara dhe dy xhepa të pjerrët në anësore para, një xhep prapa me kapak në krahun e djathtë. Pantallonat në dy anësoret, në bashkimin e përparsve me pjesën e prapme të tyre, përshkohen nga shirit i kuq 3-4 mm, nga qemeri deri në fund të pantallonave.

Këpuçë gjysma. Materiali lëkurë natyrale boks viçi. Pjesa e poshtme është shollë gome kompakte e presuar. Këpuca mund të ketë punime të lehta në suprinë, me pak majë jo të theksuar, me lidhëse të zakonshme me gjatësi të pranueshme dhe me 4 (katër) vrima, me syze metalike në të dyja anët.

Çorape ngjyrë të zeza, leshi për stinën e dimrit dhe pambuk për stinën e verës.

Doreza lëkure janë me ngjyrë të zezë, me material shevro keci.

Rrip pantallonash Materiali të jetë sintetik, fill i thurur. Ngjyra e rripit, e zezë. Mbërthimi me togëz metalike, me ngjyrë të artë.

4. UNIFORMA PËR SHËRBIM E STËRVITJE

Uniforma për shërbim e stërvitje do të jetë:

- verore,
- dimërore.

Unifonma për shërbim e stërvitje përbëhet nga: kostumi, këpuçë me qafa stërvitjeje, bluzë vere, bluzë dimri, rrip mesi, shall.

Kostumi veror (2 kapela, 1 xhakëtë, 1 palë pantallona), materiali terital veror ngjyrë e zezë, me përzierje 30 % viskozë dhe 70 % poliestër + 5 %, masa 180 +/-3 gr/m².

Xhaketa. Është me jakë të hapur. Në pjesën e sipërme të gjoksit ka dy xhepa të brendshëm me kapak që mbyllet me velkrof femër-mashkull. Një xhep pllakë me kapak që mhylllet me velkrof femër-mashkull në krahun e majtë të mëngës. Përparset mbërthehen me 5 kopsa në sallki. Mëngët janë me ylyk me velkrof femër-mashkull për shtrëngimin e tyre, 5 cm nga buza e saj përshkohen nga një fileto e kuqe 3-4 mm. Në pjesën e brendshme të mëngëve vendoset ylyku dhe kopsa për mbajtjen e mëngës së përveshur (mbledhur). Në shpatulla përshkohet nga një fileto e kuqe 3-4 mm, në supe ka spaleta, të cilat në anësore përshkohen nga një fileto e kuqe 3 - 4 mm, deri në bashkimin me jakën.

Pantallonat. Pantallonat janë me dy pensa (pala) përpara, dy xhepa të pjerrët në anësore dhe 2 xhepa pllakë prapa me kapak. Pantallonat në pjesët anësore të kofshëve kanë dy xhepa pllakë me kapak që mbyllet me velkrof femër-mashkull. Pantallonat, në pjesën e gjunjëve dhe të të ndenjurrave bëhen me fortesë nga i njëjti material. Pantallonat në dy anësoret, në bashkimin e përparsve me pjesën e prapme të tyre, përshkohen nga shirit i kuq 3-4 mm, nga qemeri deri në fund të pantallonave.

Kapela. Kapela, prej të njëjtit material si i kostumit, përbëhet nga pjesa e sipërme ose tepeleku,

rrethi dhe streha. Streha është material plastikë e hollë dhe vishet me të njëjtin material si të kapelës së cilës i kalohet tegel zbulurimi. Pjesa rreth e rrotull kapelës, ku bashkohet tepeleku me rrethin, përshkohet nga një shirit i kuq 3-4 mm. Pjesa e brendshme e kapelës vishet me astar të zi.

Kostum dimri (1 beretë, 1 xhakëtë, 1 palë pantallona), materiali stof terital dimëror me përzierje 30 % viskoze dhe 70 % poliestër +/- 5 % ngjyrë e zezë, masa 240+/-8 gr/m².

Xhaketa. Është me jakë të hapur, në pjesën e sipërme të gjoksit ka dy xhepa të brendshëm me kapak që mbyllen me velkrof femër-mashkull. Një xhep pllakë me kapak që mbyllet me kopsë në krahun e majtë të mëngës. Përparset mbërthehen me 5 kopsa në sallki. Mëngët janë me ylyk, me velkrof femër-mashkull për shtrëngimin e tyre, 5 cm nga buza e saj përshkohet nga një fileto e kuqe 3-4 mm. Mëngët në bërryla bëhen me fortesë nga i njëjti material. Në shpatulla përshkohet nga një fileto e kuqe 3-4 mm, në supe ka spaleta, të cilat në anësore përshkohet nga një fileto e kuqe 3-4 mm, deri në bashkimin me jakën.

Pantallonat. Pantallonat janë me dy pensa (pala) përpara, dy xhepa të pjerrët në anësore dhe 2 xhepa pllakë prapa me kapak. Pantallonat në pjesën anësore të kofshëve kanë dy xhepa pllakë me kapak që mbyllen me velkrof femër-mashkull. Pantallonat, në pjesën e gjunjëve dhe të ndenjurrave bëhen me fortesë nga i njëjti material. Pantallonat, në dy anësoret, në bashkimin e përparëve me pjesën e prapme të tyre, përshkohet nga shirit i kuq 3-4 mm, nga qemeri deri në fund të pantallonave.

Bereta. Është material 100% lesh, ngjyrë e zezë, përbëhet nga pjesa e sipërme ose tepeleku dhe rrethi. Pjesa rreth e rrotull beretës, ku bashkohet tepeleku me rrethin, përshkohet nga një shirit i kuq 3-4 mm. Pjesa e brendshme e beretës vishet me astar të zi.

Këpucë me qafa stërvitjeje. Lëkurë natyrale vaqet kundër ujit. Astar meshini. Pjesa e poshtme e këpucës është gomë e presuar. Fiap gome, taban soleti.

Bluzë vere. Materiali tekstil i trikotuar me përbërje 100% pambuk me ngjyrë të zezë. Masa 160+/-10gr/m². Bluza me jakë rrethore me gjerësi 3cm dhethurje llastik 2+2. Bluza në pjesën e majtë të gjoksit ka të stampuar me ngjyrë të bardhë stemën e Gardës. Në pjesën e shpatullave ka të stampuar me ngjyrë të bardhë mbishkrimin “GARDA”-shkrimi “Times New Roman”, shkronja “Kapitale” me lartësi 8 cm.

Bluzë dimri. Materiali trikotazh,thurje tute dyshtresore, me push nga njëra anë, 100% pambuk, me ngjyrë të zezë, masa 400 +/- 10 gr/m². Bluza me jakë rrethore gjysëm golfi, me gjerësi 4-5 cm dhethurje llastik 2+2. Bluza në pjesën e majtë të gjoksit ka të stampuar me ngjyrë të bardhë stemën e Gardës. Në pjesën e shpatullave ka të stampuar me ngjyrë të bardhë mbishkrimin “GARDA” - shkrimi “Times New Roman”, me shkronja “Kapitale”, me lartësi 8 cm.

Rrip mezi. Materiali të jetë sintetik fill i thurur. Ngjyra e zezë. Mbërthimi me togëz ebaniti të zezë dhe me çifte syzash metalike në gjithë gjatësinë e rripit.

Shall. Materiali 100% sintetik (atlas) ngjyrë e kuqe.

SPECIFIKIME TEKNIKE TË GRADAVE

Gradat për oficerë

a) Për kostumin ceremonial (grada supi me elemente metalike)

Elementet bazë janë yjet dhe shiritat. Shiriti kryesor (me gjerësi 1.6 cm për gradat e nivelit të ulët e të mesëm; 2 cm për gradat e nivelit të lartë; 2.4 cm për gradën madhore). Është i stilizuar në formën e një kështjelle me bedena, me rreshta (4mm secili). Në shiritin e kalasë mbivendosen dy çifte shpatash të kryqëzuara, në mes të të cilave qëndron përkrenarja e Skënderbeut. Shiriti tjetër është i stilizuar në formën e një kështjelle pa bedena, me një rresht për gradat e nivelit të ulët e të mesëm, me dy rreshta për gradat e nivelit të lartë, me tre rreshta për gradën madhore, me gjerësi sipas nivelit të gradave (me gjerësi, nga 0.4 cm për gradat e nivelit të ulët e të mesëm, 0.8 cm për gradat e nivelit të lartë, 1.2 cm për gradën madhore).

Elementet për të gjitha nivelet e gradave punohen me material metalik në ngjyrë të artë. Elementet e gradave kanë të montuar në pjesën e poshtme kapse metalike me vidë për fiksimin e tyre në mënyrë të palëvizshme në spaletën e xhakëtës.

Dimensionet

- **Për gradën madhore,** një shirit kështjelle e stilizuar (me gjashtë rreshta nga 4 mm secili) me lartësi 2.4 cm e gjerësi 4.5 cm dhe shiritin tjetër (me tre rreshta nga 4mm secili) me lartësi 1.2 cm e gjerësi 4.5 cm. Në qendër të spalines vendoset ylli me diametër 3.5 cm.

- **Për gradat e larta**, një shirit kështjelle e stilizuar (me pesë rreshta nga 4 mm secili) me lartësi 2 cm e gjerësi 4.5 cm dhe shiritin tjetër (me dy rreshta nga 4mm secili) me lartësi 0.8 cm e gjerësi 4.5 cm. Yjet janë me diametër 2.5 cm.

- **Për gradat e mesme dhe të ulta**, një shirit kështjelle e stilizuar (me katër rreshta nga 4mm secili) me lartësi 1.6 cm e gjerësi 4.5 cm dhe shiritin tjetër (me një rresht 4mm) me lartësi 0.4cm e gjerësi 4.5 cm. Yjet janë me diametër 1.75 cm.

Shiriti i parë (kalaja e stilizuar me bedena) vendoset 0.5cm larg nga baza e fundit e spalines, shiriti i dytë (kalaja e stilizuar pa bedena) vendoset 0.3 cm nga i pari. Yjet sipas gradave vendosen në vijë të drejtë mbi spalinë. Për gradën e Gjeneralit, ylli vendoset në qendër. Për gradat e larta, ylli i parë vendoset 0.6 cm larg nga shiriti kështjellë me bedena, ndërsa yjet e tjera vendosen të baraslarguar në mënyrë uniforme larg njëri-tjetrit. Për gradat e mesme dhe të ulëta, ylli i parë vendoset 1.2 cm larg nga shiriti kështjellë me bedena, ndërsa yjet e tjera vendosen të baraslarguara në mënyrë uniforme larg njëri-tjetrit.

b) Për kostumin e oficerit, xhakovento, pulovër dhe këmishë (grada supi me këllëf).

Gradat ndërtohen në formën e një këllëfi me dimensione 14.5 cm gjatësi dhe 4.9 cm gjërësi. Grada përshkohet në gjithë perimetrin e saj nga shiriti plastik me ngjyrë të artë, me gjerësi 2mm. Elementet formuese të gradave janë yjet dhe shiritat në formën e kalasë së stilizuar. Këto elemente për të gjitha nivelet e gradave janë në formë e madhësi të njëjtë me ato të gradave të uniformës ceremoniale. Shiriti i parë (kalaja e stilizuar me bedena) vendoset 0.3 cm larg nga baza e fundit e shiritit të artë plastik që kufizon gradën. Elementet e tjera ruajnë të njëjtat distanca si tek gradat e uniformës ceremoniale.

Prodhen me material plastik me ngjyrë të artë dhe vendosen me termofiksime mbi një copë tekstili të zezë, të përforcuar nga brenda me shtresë plastike.

Gradat për nënoficerë

a) Për kostumin ceremonial (grada supi me elemente metalike)

Element bazë janë shiritat. Shiriti i parë, me lartësi 1.2 cm e gjerësi 4.5 cm, i stilizuar në formën e një kështjelle me tre rreshta (4 mm secili), është i njëjtë për të gjitha nivelet e gradave të nënoficerit. Në shiritin e kalasë së stilizuar, mbivendosen dy çifte shpatash të kryqëzuara, në mes të cilave qëndron përkrenarja e Skënderbeut. Shiritat e tjerë janë në formë harkore me gjerësi 0.5 cm e gjatësi 4.1 cm. Për gradat e nivelit të lartë dhe gradën “Kryekapit” element formues të gradës janë dhe shiritat këndorë (110°), me gjerësi 0.5 cm e gjatësi 4.1 cm. Grada më e lartë e nënoficerit, në mes të hapësirës ndërmjet shiritave harkorë e këndor, ka yllin me diametër 1.5 cm.

Shiriti i parë (kalaja e stilizuar në formën e një kështjelle me tre rreshta) vendoset 0.5 cm larg nga baza e fundit e spalines, shiriti i dytë (në formë harkore) vendoset 1cm nga i pari dhe 0.5 cm nga njëri-tjetri. Për gradat e nivelit të lartë, shiriti këndor vendoset 0.5 cm nga ai harkor dhe 0.5 cm nga njëri-tjetri. Në gradën më të lartë të nënoficerit shiriti këndor vendoset 1 cm nga ai harkor dhe 0.5 cm nga njëri-tjetri, ylli vendoset në mes të shiritave harkorë e këndorë.

b) Për kostumin e nënoficerit, xhakovento, pulovër dhe këmishë (grada supi me këllëf)

Gradat ndërtohen në formën e një këllëfi me dimensione 14.5 cm gjatësi dhe gjërësi 4.9 cm. Grada (këllëf) përshkohet në të gjithë perimetrin e saj nga një shirit plastik me ngjyrë të artë, me gjërësi 2 mm. Elementet formuese për të gjitha nivelet e gradave janë në formë e madhësi të njëjtë me ato të gradave të uniformës ceremoniale të nënoficerit. Shiriti i parë (kalaja e stilizuar në formën e një kështjelle me tre rreshta) vendoset 0.3 cm larg nga baza e fundit e shiritit të artë plastik që kufizon gradën. Elementet e tjera ruajnë të njëjtat distanca si tek gradat e uniformës ceremoniale.

Këto grada prodhen me material plastik me ngjyrë të artë dhe vendosen me termofiksime mbi një copë tekstili të zezë, të përforcuar nga brenda me shtresë plastike.

Gradat për uniformë shërbimi e stërvitje (grada në gjoks)

Elementet formuese për të gjitha gradat e gjoksit për oficerë e nënoficerë, janë në formë të njëjtë me ato të gradave të supit për oficerë e nënoficerë, ndërsa përmasat e elementeve të këtyre gradave janë në masën 60 % të elementeve të gradave të supit. Të gjitha elementet e gradave janë të qëndisura me fije në ngjyrë ari, në copë tekstili me ngjyrë të zezë të përforcuar nga brenda. Këto grada vendosen në krahun e majtë të gjoksit mbi kapakun e xhepit, me anë të një velkrofi femër-mashkull. Në pjesët anësore rrethohet me shirit ngjyrë ari me gjerësi 2 mm. Të gjitha gradat janë në formë drejtkëndëshi me dimensione 8.5 x 3

cm.

Emblema e kapelës (e madhe, e vogël)

Ngjyra është e artë për të dy emblemat. Elementi bazë është shqiponja e flamurit, e punuar me material metalik, me përkrenaren e Skënderbeut me profil nga e djathta, e vendosur mbi dy kokat e shqiponjës, të rrethuara me një kurorë gjethe lisi.

Emblema montohet në kapele me anë të një vidhe. Emblema e madhe ka përmasa 6.5 cm x 5.5 cm. Emblema e vogël 4.5 cm x 3.5 cm.

Stema e Republikës

Material tekstil, i qëndisur me penj sipas ngjyrave të çdo elementi të stemës. Stema është në formën e një mburoje me përmasa 7.5 x 6 cm. Pjesa e sipërme është e drejtë, ndërsa pjesa e poshtme në formë ovale (shqyti). Fusha është në ngjyrë të kuqe, në mes të së cilës gjendet shqiponja dykrenare me ngjyrë të zezë, mbi të cilën në qendër vendoset përkrenarja e Skënderbeut ngjyrë ari, me profil nga e djathta. Stema rrethohet me një kornizë ngjyrë ari, me gjerësi 2 mm. Stema montohet në krahun e majtë me anë të një velkrofi femër mashkull.

Stema e Gardës së Republikës

Material tekstil, i qëndisur me penj sipas ngjyrave të çdo elementi të stemës. Stema është në formën e një mburoje me përmasa 7.5 x 6 cm. Pjesa e sipërme është e drejtë ndërsa pjesa e poshtme në formë ovale (shqyti). Fusha është në ngjyrë të kuqe. Stema rrethohet me një kornizë ngjyrë ari, me gjerësi 2 mm. Në largësi 1 cm në brendësi të kornizës së parë ka një kornizë tjetër ngjyrë ari të vijëzuar me gjerësi 1-1.2 mm. Në mes të kornizës së dytë ka një shirit me ngjyrë të zezë, me gjerësi 2 cm, që fillon nga pjesa e sipërme e kornizës së dytë e deri në fund të saj. Mbi shiritin e zi në qendër qëndron përkrenarja e Skënderbeut, në ngjyrë ari, në profil, mbi dy shpata me ngjyrë të artë, të kryqëzuara. Në mes të kornizës së parë e të dytë, shkruhet me shkronja kapitale dhe të zezë (me shkrim “Arial” e me bold), me lartësi 6 mm, me ngjyrë të bardhë, fjala “GARDA” në pjesën e sipërme dhe fjala “E REPUBLIKËS” në pjesën e poshtme në formë ovale. Stema montohet në krahun e djathtë, me anë të një velkrofi femër-mashkull.

Shenja e emrit

Shenja e emrit është me përmasa 8.5 cm gjatësi, 2 cm gjerësi. Material i gomuar, me sfond të zi, i cili rrethohet me një kornizë ngjyrë ari me gjerësi 2mm. Shenja në krahun e majtë ka përkrenaren e Skënderbeut, në profil nga e djathta dhe në pjesën tjetër shkruhet me shkronja kapitale, me shkrim “Arial”, bold, me lartësi 10 mm, me ngjyrë të artë, mbiemri i oficerit apo nën/oficerit të Gardës. Të gjitha elementet e shenjës së emrit punohen mbi materialin e gomuar në relief. Montimi i shenjës në uniformë bëhet me velkrof mashkull-femër, mbi kapakun e xhepit të djathtë të gjoksit.

Shenja e jakës

Elementet bazë të shenjës së jakës janë: dy kurora me gjethe lisi, të bashkuara në pjesën e poshtme, ndërsa në pjesën e sipërme, largësia mes kurorave është 5 cm, lartësia 3.5 cm. Në mes të kurorave vendosen përkrenaret e Skënderbeut, me dimensione 2.5 x 1.7 cm, në profil, që shikojnë nga njëra-tjetra. Ato vendosen në dy anët e jakës së sipërme të xhakëtës, sipas vijës së qepjes së jakave. Të gjitha elementet e shenjës së jakës janë me material metalik me ngjyrë ari.

Shenjat e armës së Gardës

Shenja e armës Gardës është me përmasa 2 cm gjerësi, 1.3 cm lartësi. Elementi bazë është kala e stilizuar me një bedenë, me përmasa 2 cm x 0,5 cm, mbi të cilën vendosen dy shpata të kryqëzuara me përmasa 0.5 cm x 0.4 cm. Shenja në pjesën e poshtme është në formë gjysmërrethore, ku shkruhet “GARDA E REPUBLIKËS”. Shenja është e punuar me material metalik ngjyrë ari. Vendoset në të dy anët e jakës së poshtme të xhakëtës.

Shenjat dalluese të armëve e shërbimeve

Janë me material metalik me ngjyrë ari sipas modeleve të përcaktuara, për çdo armë e shërbim. Vendosen në të dy anët e jakës së poshtme të xhakëtës.

Shenjë gjoksi (për gradën madhore dhe gradat e larta)

Shenja e gjoksit është me përmasa 8.5 cm gjatësi, 2 cm gjerësi për gradat e larta dhe 8.5 cm gjatësi, 2.4 cm gjerësi për gradën madhore. Elementi bazë është një kështjellë e stilizuar me bedena të

shkallëzuara, me dy shpata të kryqëzuara në qendër. Ka gjashtë rreshta (4mm secili) për gradën madhore dhe pesë rreshta (4 mm secili) për gradat e larta. Në pjesën e pasme stema ka të montuar me perçina një kapse suste për fiksimin në mënyrë të palëvizëshme të saj në xhakëtë. Material metalik me ngjyrë ari.

Dekoratat, medaljet

Dekoratat, medaljet vendosen në anën e majtë të kraharorit, sipër xhepit të xhakëtës, në raste ceremoniale festash, përvjetorësh etj. Vendosija e tyre bëhet nga tre copë në çdo radhë sipas rëndësisë, duke filluar nga e djathta në të majtë dhe nga lart-poshtë. Shiritat të cilat përfaqësojnë medaljen e dhënë, vendosen dhe mbahen në unifonmën e oficerit e nënoficerit të Gardës.

Shenjat e arsimit dhe të kurseve

Jepen nga institucionet përkatëse arsimore dhe vendosen në kraharorin e djathtë, 1 cm mbi shenjën e emrit.

Kopsat e mëdha dhe të vogla

Janë metalike me ngjyrë të artë për të gjitha llojet e gradave. Kopsat në qendër të tyre kanë të stampuar në relief shenjën dalluese përkrenaren e Skënderbeut në profil me pamje nga e djathta, ku shkruhet në mënyrë gjysmë rrethore me shkronja kapitale “GARDA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”. Kopsa e madhe është në formë të rrumbullakët, me diametër 2.3 cm, kopsa e vogël me diametër 1.5 cm.

Kopsat e kapelës

Në përbërje forme e përmasa janë të njëjta me kopsat e vogla të xhakëtës.

Shiritat e kapelës

Shiriti i kapelës, për uniformën e gradës madhore “Gjeneral”, është një kordon dysh i thurur ngjyrë ari, në dy anët e të cilit vendoset nga një kondon tek i thurur ngjyrë ari. Në uniformën e trupprojës së nderit, uniformën ceremoniale e atë të oficerit të gradave të larta është vetëm një kordon dysh i thurur ngjyrë ari. Kordoni është me përbërje 70% sintetik dhe 30% pambuk. Shiriti në dy ekstremet montohet me kopsa tip vidhe.

Në uniformën ceremoniale e atë të oficerit, për gradat e mesme e të ulëta, shiriti është material plastik me metalizim me ngjyrë ari, ku është e punuar në relief një degëzim gjethe lisi. Për nënoficerët shiriti i kapelës është i njëjtë me atë të oficerëve të gradave të mesme e të ulëta, por pa punim të gjethes.

Dekoracioni i strehës së kapelës (për uniformën e trupprojës së nderit, uniformën e gradës madhore dhe uniformën e oficerëve të gradave të larta)

Elementet bazë janë dekoracioni kuror gjethe lisi, në formë harkore sipas strehës së kapelës. Të gjitha elementet e dekoracionit të kapelës janë qëndisura me fije ngjyrë ari. Dekoracioni kurorë mbështetet në të gjithë gjerësinë e strehës së kapeles. Gjerësia e dekoracionit në anë 1cm, duke u zgjeruar në qendër 2 cm. Grada e Gjeneralit ka dy elemente kurore, kurse uniforma e trupprojës së nderit dhe ajo e oficerëve të gradave të larta, një element kurore.

VENDIM

Nr.137, datë 11.2.2009

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS “SKËNDERBEG”, NË BASHKINË E SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për

interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni i rrugës “Skënderbeg”, në bashkinë e Shkodrës.

2. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 287.86 (dyqind e tetëdhjetë e shtatë pikë tetëdhjetë e gjashtë) m², tokë/truall, dhe 78.85 (shtatëdhjetë e tetë pikë tetëdhjetë e pesë) m² ndërtesë, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 7 914 549 (shtatë milionë e nëntëqind e katërmëdhjetë mijë e pesëqind e dyzet e nëntë) lekë.

3. Ky fond të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Shkodrës, planifikuar në buxhetin e vitit 2008.

4. Shpenzimet procedurale të përballohen po nga bashkia e Shkodrës.

5. Shpronësimi të përfundojë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndërsa rikonstruksioni i rrugës të përfundojë brenda afateve të parashikuara nga bashkia e Shkodrës.

6. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Shkodrës dhe regjistrimi i pasurisë, 287.86 (dyqind e tetëdhjetë e shtatë pikë tetëdhjetë e gjashtë) m², tokë/truall, dhe 78.85 (shtatëdhjetë e tetë pikë tetëdhjetë e pesë) m² ndërtesë, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Proces regjistrimi”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, me përfundimin e procesit të regjistrimit dhe pasi të kenë dorëzuar dokumentacionin e pronësisë, pranë bashkisë së Shkodrës. Deri në këtë çast, paratë të qëndrojnë të bllokuara në bankë.

8. Bashkia e Shkodrës të kryejë likuidimin e pronarëve, sipas dokumentacionit të pronësisë.

9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Shkodrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PRONARËVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PER RIKONSTRUKSIONIN E
RRUGËS “SKËNDERBEG”, BASHKIA SHKODËR

Nr.	Emrat e pronarëve	Sip. trualli i lirë+truall nën objekt m ²	Çmimi për njësi, lekë	Vlera sip. trualli, lekë	Sip. Objekti, m ²	Çmimi për njësi, lekë	Vlera e objektit, lekë	Amortizimi në vite i objektit, lekë	Vlera totale, lekë	Dokumentacioni i pronësisë
1	Tone Frroku	35.1	21564	756896					756896	Vërtetim pronësie
2	Gjyste Marku	36	21564	776304					776304	Vërtetim pronësie
3	Ndrek,etj.Kabashi	33.12	21564	714200	13.5	28350	382725	97978	998947	Vërtetim pronësie
4	Marije Serreqi	27.4	21564	590854	6.5	28350	184275	47174	727955	Vërtetim pronësie
5	Mark Frroku	18	21564	388152					388152	Në proces
6	Adelina Simoni	30	21564	646920	34.6	28350	980910	251113	1376717	Vërtetim pronësie
7	Anton Frroku	25.06	21564	540394					540394	Vërtetim pronësie
8	Mikel Çeka	40.68	21564	877224					877224	Vërtetim pronësie
9	Filip e Eugen Çeka	0		0	18	28350	510300	97977	412323	Vërtetim pronësie
10	Engjëll Çeka	11.5	21564	247986					247986	Në proces
11	Trg. e Shaqir Kadia	24.75	21564	533709					533709	Vërtetim pronësie
12	Muhamet Dizdari	6.25	21564	134775	6.25	28350	177187	34020	277942	Në proces
	Shuma totale	287.86	21564	6207414	78.85	28350	2235397	528262	7914549	

VENDIM
Nr.138, datë 11.2.2009

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS
“ISUF SOKOLI”, NË BASHKINË E SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni i rrugës “Isuf Sokoli”, në bashkinë e Shkodrës.

2. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 456.2 (katërqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë dy) m², tokë/truall, dhe 434.34 (katërqind e tridhjetë e katër pikë tridhjetë e katër) m² ndërtesë, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 14 264 814 (katërmbydhjetë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e tetëqind e katërmbydhjetë) lekë.

3. Ky fond të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Shkodrës, planifikuar në buxhetin e vitit 2008.

4. Shpenzimet procedurale të përballohen po nga bashkia e Shkodrës.

5. Shpronësimi të përfundojë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndërsa rikonstruksioni i rrugës të përfundojë brenda afateve të parashikuara nga bashkia e Shkodrës.

6. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Shkodrës dhe regjistrimi i pasurisë, 456.2 (katërqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë dy) m², tokë/truall, dhe 434.34 (katërqind e tridhjetë e katër pikë tridhjetë e katër) m² ndërtesë, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Proces regjistrimi”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, me përfundimin e procesit të regjistrimit dhe pasi të kenë dorëzuar dokumentacionin e pronësisë, pranë bashkisë së Shkodrës. Deri në këtë çast, paratë të qëndrojnë të bllokuara në bankë.

8. Bashkia e Shkodrës të kryejë likuidimin e pronarëve, sipas dokumentacionit të pronësisë.

9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Shkodrës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PRONARËVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR
RIKONSTRUKSIONIN E RRUGËS “ISUF SOKOLI” NË BASHKINË SHKODËR

Nr.	Emërtimi i objektit	S.truall i lirë	Çmimi për njësi	Vlera S tr.i lirë	S.truall i nën objekt	Çmim i për njësi	Vlera S.tr.nën objekt	Sipër.f. objekti	Çmimi për njësi	Vlera e objektit	Amortiz imi në vite obj.	Vlera totale	Dokumenti i pronësisë
a	b	m ²	lekë	lekë	m ²	lekë	lekë	m ²	lekë	lekë	lekë	lekë	n
		c	d	e	f	g	h	i	j	k	l	m=e+h+ (k-l)	
1	Sytqi Legreta	5	21564	107820								107820	Proces
2	Mahir Hoti	33.3	21564	718081								718081	Proces
3	Fasli Smaka	43.7	21564	942347								942347	Vërt. pronësie
4	Avenir Kalaja											0	Vërt. pronësie
5	Mehmet Brucaj	25	21564	539100	25	21564	539100	215	28350	6095250	4754295	2419155	Vërt. pronësie
6	Ylli Curri	4	21564	86256	10	21564	215640	130.8	28350	3708180	2892380	1117696	Vërt. pronësie
7	Ismail Dibra	136.04	21564	2933566	29.36	21564	633119	61.49	28350	1743241	167351	5142575	Proces
8	Agim Hasan Belli	37.9	21564	817276	4.1	21564	88412	8.25	28350	233888	22453	1117123	Proces
9	Trashig. Hekuran Pepa	52.4	21564	1129954	9.8	21564	211327	18.8	28350	532980	51166	1823095	Proces
10	Xhahit, Hafsa, Adnan Bushati	40.7	21564	876922		21564						876922	Vërt. pronësie
	Shuma			8151322			1687598			12313539	7887645	14264814	

VENDIM
Nr.139, datë 11.2.2009

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 478, DATË 18.7.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës“, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009“, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të shkronjës “a” të pikës 1 të vendimit nr.478, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohen edhe emërtesat “Shërbimi Gjeologjik Shqiptar dhe Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Agjencia e Pagesave)”.

2. Pagat e punonjësve të tjerë të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Agjencia e Pagesave) dhe të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar të përcaktohen në përputhje me vendimin për përcaktimin e pagave për punonjësit mbështetës të institucioneve buxhetore.

3. Efektet financiare, për vitin 2009, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore, të miratuara për këto institucione në ligjin nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.140, datë 11.2.2009

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.624, DATË 21.12.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË PALËS SHQIPTARE,
PJESËMARRËSE NË FORCËN SHUMËKOMBËSHE TË EUROPËS JUGLINDORE, DHE TË
DREJTAT E USHTARAKËVE AKTIVË, PJESËMARRËS NË KËTË FORCË”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8544, datë 4.11.1999 “Për ratifikimin e marrëveshjes dhe të protokollit shtesë për krijimin e forcës shumëkombëshe të Europës Juglindore”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.624, datë 21.12.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Në titullin e vendimit fjalët “... dhe të drejtat e ushtarakëve aktivë, pjesëmarrës në këtë forcë”, shfuqizohen.

b) Kreu II “TË DREJTAT E USHTARAKËVE” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.144, datë 11.2.2009

**PËR MIRATIMIN E FORMULARËVE TË VETËDEKLARIMIT, PËR TË USHTRUAR
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT ME SHUMICË TË BARNAVE, TË TREGTIMIT NË
FARMACI DHE AGJENCI FARMACEUTIKE, SI DHE TË IMPORT-EKSPORTIT TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 24, pika 9, 32, pika 11, 35, pika 2, e 46, pika 2 të ligjit nr.9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e formularëve të vetëdeklarimit, për të ushtruar veprimtarinë e tregtimit me shumicë të barnave, të tregtimit në farmaci dhe agjenci farmaceutike, si dhe të import-eksportit të tyre, sipas modeleve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Datë _____

VETËDEKLARIM

TREGTIMI ME SHUMICË I BARNAVE

DREJTUAR: _____

Unë i nënshkruari (administratori).....deklaroj që jam banues
në.....në adresë.....me
seli.....tel.....cel.....dhe me dokument identifikimi / nr i
pasaportës.....Drejtuesi teknik i aktivitetit znj./z.....

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Jam i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit si person Juridik.... PO / JO
 - Disponoj ekstraktin e regjistrimit nga QKR me objektin përkatës në fushën që
kërkoj të licencohem.....PO / JO
 - Nuk jam në proces gjykimi, hetimi apo të jem i dënuar në fushën që kërkoj të
ushtroj aktivitetin..... PO / JO
 - Vërtetim tatimesh për shlyerjen e detyrimeve tatimore.....PO / JO
 - Licencë të mëparshme..... PO / JO
 - Leje higjieno-sanitare me objektin e veprimtarisë që do të ushtroj.....PO / JO
 - Disponoj certifikatë anëtarësimi nga Urdhri i Farmacistëve, si drejtues teknik
lëshuar në bazë të dplomës dhe përvojës profesionale në farmaci sipas ligjit
në fuqi.....PO / JO
 - Genplani i ambientit mbi 90 m² lëshuar nga arkitekt / inxhinier i licencuar.. PO / JO
 - Vërtetim pronësie ose planimetrie e ambientit lëshuar nga arkitekt / inxhinier i
licencuar..... PO / JO
 - Kontratë punësimi për drejtuesin teknik..... PO / JO
 - Subjekti përmbush “Praktikën e ruajtjes së mirë të barnave” sipas ligjit në fuqi
.....PO /
- JO
- Subjekti përmbush “Praktikën e shpërndarjes së mirë të barnave sipas ligjit në
fuqi..... PO / JO.

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se të gjitha të dhënat e mësipërme janë të vërteta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Deklarimi i rremë, qoftë edhe i njërit prej kritereve të kërkuara, sjell përjashtimin tim nga çdo procedurë e mëtejshme për aplikimin përkatës.

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Njoh kuadrin ligjor dhe nënligjor në fushën që kërkoj të ushtroj aktivitetin.
- Do të zbatoj të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi.

Bashkëlidhur këtij formulari vetëdeklarimi genplani/planimetria dhe mandatpagesa.

Datë _____

VETËDEKLARIM

IMPORT – EKSPORTI I BARNAVE

DREJTUAR: _____

Unë i nënshkruari (administratori).....deklaroj që jam banues
në.....në adresë.....me
seli.....tel.....cel.....dhe me dokument identifikimi / nr i
pasapoetës.....Drejtuesi teknik i aktivitetit znj. / z.....

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Jam i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit si person juridik.... PO / JO
 - Disponoj ekstraktin e regjistrimit nga QKR me objektin përkatës në fushën që
kërkoj të licencohem.....PO / JO
 - Nuk jam në proces gjykimi, hetimi apo të jem i dënuar në fushën që kërkoj të
ushtroj aktivitetin..... PO / JO
 - Vërtetim tatimesh për shlyerjen e detyrimeve tatimore..... PO / JO
 - Licencë të mëparshme..... PO / JO
 - Leje higjieno-sanitare me objektin e veprimtarisë që do të ushtroj..... PO / JO
 - Disponoj certifikatë anëtarësimi nga Urdhri i Farmacistëve, si drejtues teknik
lëshuar në bazë të diplomës dhe përvojës profesionale në farmaci sipas ligjit
në fuqi.....PO / JO
 - Genplani i ambientit mbi 90 m² lëshuar nga arkitekt/inxhinier i licencuar.. . PO / JO
 - Vërtetim pronësie ose planimetrie e ambientit lëshuar nga arkitekt/inxhinier i
licencuar.....PO / JO
 - Kontratë punësimi për drejtuesin teknik..... PO / JO
 - Subjekti përmbush “Praktikën e ruajtjes së mirë të barnave” sipas ligjit në fuqi
.....PO /
- JO
- Subjekti përmbush “Praktikën e shpërndarjes së mirë të barnave sipas ligjit në
fuqi..... PO / JO.

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se të gjitha të dhënat e mësipërme janë të vërteta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Deklarimi i rremë, qoftë edhe i njërit prej kriterëve të kërkuara, sjell përjashtimin tim nga çdo procedurë e mëtejshme për aplikimin përkatës

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Njoh kuadrin ligjor dhe nënligjor në fushën që kërkoj të ushtroj aktivitetin.
- Do të zbatoj të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi.

Bashkëlidhur këtij formulari vetëdeklarimi genplani/planimetria dhe mandatpagesa.

Datë _____

VETËDEKLARIM

PËR HAPJEN E FARMACIVE

DREJTUAR: _____

Unë i nënshkruari (administratori).....deklaroj që jam banues
në.....në adresë.....me
seli.....tel.....cel.....dhe me dokument identifikimi / nr i
pasaportës.....Drejtuesi teknik i aktivitetit znj. / z.....

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Jam i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit si person Juridik.... PO / JO
 - Disponoj ekstraktin e regjistrimit nga QKR me objektin përkatës në fushën që kërkoj të licencohem..... PO / JO
 - Nuk jam në proces gjykimi, hetimi apo të jem i dënuar në fushën që kërkoj të ushtroj aktivitetin..... PO / JO
 - Vërtetim tatimesh për shlyerjen e detyrimeve tatimore..... PO / JO
 - Licencë të mëparshme..... PO / JO
 - Leje higjieno-sanitare me objektin e veprimtarisë që do të ushtroj..... PO / JO
 - Disponoj certifikatë anëtarësimi nga Urdhri i Farmacistëve, si drejtues teknik lëshuar në bazë të dplomës dhe përvojës profesionale në farmaci sipas ligjit në fuqi..... PO / JO
 - Vërtetim pronësie ose planimetrie e ambientit mbi 35 m² lëshuar nga arkitekt/inxhinier i licencuar.....PO / JO
 - Genplani i cili të ketë distancën 100-150 m nga farmacia më e afërt, lëshuar nga arkitekt/inxhinier i licencuar..... PO / JO
 - Kontratë punësimi për drejtuesin teknik..... PO / JO
 - Subjekti përmbush “Praktikën e ruajtjes së mirë të barnave” sipas ligjit në fuqi.....PO / JO
- JO
- Subjekti përmbush “Praktikën e shpërndarjes së mirë të barnave sipas ligjit në fuqi..... PO / JO.

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se të gjitha të dhënat e mësipërme janë të vërteta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Deklarimi i rremë, qoftë edhe i njërit prej kriterëve të kërkuara, sjell përjashtimin tim nga çdo procedurë e mëtejshme për aplikimin përkatës

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Njoh kuadrin ligjor dhe nënligjor në fushën që kërkoj të ushtroj aktivitetin.
- Do të zbatoj të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi.

Bashkëlidhur këtij formulari vetëdeklarimi genplani/planimetria dhe mandatpagesa.

Datë _____

VETËDEKLARIM

PËR HAPJEN E AGJENCIVE FARMACEUTIKE

DREJTUAR: _____

Unë i nënshkruari (administratori).....deklaroj që jam banues
në.....në adresë.....me
seli.....tel.....cel.....dhe me dokument identifikimi / nr i
pasaportës.....Drejtuuesi teknik i aktivitetit znj. / z.....

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Jam i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit si person juridik.... PO / JO
 - Disponoj ekstraktin e regjistrimit nga QKR me objektin përkatës në fushën që
kërkoj të licencohem..... PO / JO
 - Jam i regjistruar në organet tatimore me nr.NIPT-i..... PO / JO
 - Nuk jam në proces gjykimi, hetimi apo të jem i dënuar në fushën që kërkoj të
ushtroj aktivitetin.....PO / JO
 - Vërtetim tatimesh për shlyerjen e detyrimeve tatimore..... PO / JO
 - Licencë të mëparshme..... PO / JO
 - Leje higjieno-sanitare me objektin e veprimtarisë që do të ushtroj..... PO / JO
 - Disponoj certifikatë regjistrimi nga Urdhri i Farmacistëve.....PO / JO
 - Vërtetim pronësie ose planimetrie e ambientit mbi 15 m²lëshuar nga arkitekt/inxhinier
i licencuar.....PO / JO
 - Kontratë punësimi për drejtuesin teknik..... PO / JO
 - Subjekti përmbush “Praktikën e ruajtjes së mirë të barnave” sipas ligjit në fuqi
.....PO /
- JO
- Subjekti përmbush “Praktikën e shpërndarjes së mirë të barnave sipas ligjit në
fuqi..... PO / JO.

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se të gjitha të dhënat e mësipërme janë të vërteta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Deklarimi i rremë, qoftë edhe i njërit prej kriterëve të kërkuara, sjell përjashtimin tim nga çdo procedurë e mëtejshme për aplikimin përkatës.

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Njoh kuadrin ligjor dhe nënligjor në fushën që kërkoj të ushtroj aktivitetin.
 - Do të zbatoj të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi.
- Bashkëlidhur këtij formulari vetëdeklarimi genplani/planimetria dhe mandatpagesa.

VENDIM
Nr.146, datë 11.2.2009

PËR NJË RISHPËRNDARJE FONDESH BUXHETORE, TË MIRATUARA PËR VITIN 2009,
PËR MINISTRINË E BRENDSHME, BRENDË PROGRAMEVE BUXHETORE TË KËSAJ
MINISTRIE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për

buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2009, për programin “Shërbimi i Gjendjes Civile”, t’i shtohet fondi 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë, në zërin “Shpenzime korrente”, për mbulimin e shpenzimeve të fushatës publicitare, për nxitjen e shtetasve shqiptarë për t’u pajisur me letërnjoftim dhe pasaportë elektronike.

2. Fondi 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë të pakësohet nga zëri “Shpenzime korrente”, nga programet dhe në masën, si më poshtë vijon:

- a) Nga programi “Policia e Shtetit”, shuma 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë;
- b) Nga programi “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, shuma 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.147, datë 11.2.2009

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË KASKADËS SË HYDROCETRALEVE NË LUMIN FAN I VOGËL, DHE PËR MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të kaskadës së hidrocentraleve në lumin Fan i Vogël është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2 përqindësh të pikëve, për rezultatin teknik e financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “AS ENERGJY” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të kaskadës së hidrocentraleve në lumin Fan i Vogël, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.150, datë 11.2.2009

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.917, DATË 29.12.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE (OBJEKTE), QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR RRËSHEN-KALIMASH”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.917, datë 29.12.2007 të Këshillit të Ministrave, të bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në tabelën, që i bashkëlidhet vendimit në fuqi, vlerave të objekteve, me numrat rendorë 27, 32, 37 e 82, u shtohen, pas rivlerësimit të objekteve, përkatësisht, edhe këto vlera:

i) Vlerës 2 482 836 (dy milionë e katërqind e tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë, e përcaktuar për objektin me numër rendor 27, i shtohet edhe vlera 122 654 (njëqind e njëzet e dy mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e katër) lekë.

ii) Vlerës 1 474 687 (një milion e katërqind e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë, e përcaktuar për objektin me numër rendor 32, i shtohet edhe vlera 181 245 (njëqind e tetëdhjetë e një mijë e dyqind e dyzet e pesë) lekë.

iii) Vlerës 5 768 505 (pesë milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e pesë) lekë, e përcaktuar për objektin me numër rendor 37, i shtohet edhe vlera 2 703 282 (dy milionë e shtatëqind e tre mijë e dyqind e tetëdhjetë e dy) lekë.

iv) Vlerës 2 646 818 (dy milionë e gjashtëqind e dyzet e gjashtë mijë e tetëqind e tetëmbëdhjetë) lekë, e përcaktuar për objektin me numër rendor 82, i shtohet edhe vlera 407 294 (katërqind e shtatë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e katër) lekë.

v) Vlerës së përgjithshme të shpronësimit, prej 296 577 544 (dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e dyzet e katër) lekësh, e përcaktuar në vendimin nr.917, datë 29.12.2007, të Këshillit të Ministrave, i shtohet vlera 3 414 475 (tre milionë e katërqind e katërmëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë.

b) Në tabelën, që i bashkëlidhet vendimit në fuqi, në bazë të dokumentacionit të pronësisë, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i) Për objektin në numrin rendor 37, në pronësi të këtyre personave: Tonin Dod Nikolli, Nikoll Dod Nikolli dhe Gjet Dod Nikolli, ndryshojnë pronarët dhe bëhet ndarja e objektit në pronësi të Ded Dod Nikolli, me numër pasurie 59/9, Gjet Dod Nikolli, me numër pasurie 59/3, dhe Preng Dod Nikolli, me numër pasurie 59/8.

ii) Për objektin në numrin rendor 76, në pronësi të këtyre personave: Dod Llesh Ndreca, Nikoll Llesh Ndreca dhe Gjok Llesh Ndreca, ndryshojnë pronarët dhe bëhet ndarja e objektit në pronësi të Gjok Llesh Ndreca, me numër pasurie 167, Vasil Gjok Ndreca, me numër pasurie 237, Ilir Gjok Ndreca, me numër pasurie 165/5, Nikoll Llesh Ndreca, me numër pasurie 163, Anton Nikoll Ndreca, me numër pasurie 236, dhe Dod Llesh Ndreca, me numër pasurie 170.

2. Shtesa për shpronësim, në vlerën 3 414 475 (tre milionë e katërqind e katërmëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.

3. Likuidimi i pronarëve të fillojë më 15.2.2009 dhe të përfundojë më 15.4.2009.

4. Pronarët e shënuar në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim ZRPP”, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve, brenda afateve të përcaktuara në pikën 4 të këtij vendimi, në bazë të dokumentacionit të pronësisë.

6. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE

Lista e pronarëve që preken nga korridori Durrës – Morinë (seksioni Rrëshen – Kalimash)

Lloji i pasurisë së patundshme: objekt

[illegible]

VENDIM
Nr.151, datë 11.2.2009

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE (OBJEKTE), QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR RRËSHEN-KALIMASH

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrëshen-Kalimash.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 7 338 382 (shtatë milionë e treqind e tridhjetë e tetë mijë e treqind e tetëdhjetë e dy) lekë.
 4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 200 000 (dyqind mijë), të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 7 338 382 (shtatë milionë e treqind e tridhjetë e tetë mijë e treqind e tetëdhjetë e dy) lekë, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.
 6. Shpronësimi të fillojë më 20.2.2009 dhe të përfundojë më 20.4.2009.
 7. Pronarët që shpronësohen, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, brenda afateve të përcaktuara në pikën 6 të këtij vendimi, sipas dokumentacionit të pronësisë dhe planimetrisë përkatëse.
 9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
RRËSHEN - KALIMASH

Nr.	Pronari			ZK	Nr. Pas.	Objekti vlera lekë	Qyteti/ fshati	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri					
1	Eridan	Fran	Skana	2610	214/1	1052755	Mashterkor	Konfirmuar nga ZRPP
2	Nikoll	Ndue	Biba	2162	81/10	1395498	Klos	Konfirmuar nga ZRPP
3	Tonin	Mark	Prenga	3598	243	2618565	Thirre	Konfirmuar nga ZRPP
4	Nikoll	Gjon	Prenga	3598	244	2271564	Thirre	Konfirmuar nga ZRPP
		TOTALI				7338382		

VENDIM

Nr.154, datë 11.2.2009

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.486, DATË 25.7.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR NDËRPRERJEN E VEPRIMTARISË SË PËRPUNIMIT TË ANIJEVE, QË
TRANSPORTOJNË NAFTË, GAZ DHE NËNPRODUKTE TË TYRE, NË PORTET E
DURRËSIT DHE TË SHËNGJINIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1 e 2 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1 të vendimit nr.486, datë 27.7.2007, të Këshillit të Ministrave, fjalët “... brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.” zëvendësohen me “...deri më 30 qershor 2009.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.155, datë 11.2.2009

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION

**TË NDËRTIMIT TË PORTIT TË JAHTEVE NË KEPIN E RODONIT, GJIRI I LALZIT,
DURRËS, DHE PËR MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE
KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion, të ndërtimit të portit të jahteve në Kepin e Rodonit, Gjiri i Lalzit, Durrës, është Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

2. Koncesioni do të jetë i formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim në pronësi të shtetit).

3. Miratimin e bonusit prej 8.3 përqindësh të pikëve, për rezultatin, teknik, financiar dhe mjedisor, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Ener Alb-Projects” sh.p.k.

4. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

VENDIM

Nr.156, datë 11.2.2009

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.78, DATË 8.2.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR KRIJIMIN E MATURËS SHTETËRORE DHE PRANIMET NË SHKOLLAT E LARTA
PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 3 të vendimit nr.78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohen pikat 3.1 e 3.2, me këtë përmbajtje:

“3.1 Përfshihen nga provimet me zgjedhje kandidatët, që kërkojnë të vazhdojnë studimet në Akademinë e Edukimit Fizik dhe Sporteve, në Akademinë e Arteve dhe në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sporteve, në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër. Në këtë rast, pranimi i kandidatëve bëhet me konkurs të organizuar nga institucioni publik i arsimit të lartë përkatës. Në rast aplikimi për programe të tjera studimi, këta kandidatë u nënshtrohen provimeve me zgjedhje të maturës shtetërore.

3.2 Përfshihen nga provimet me zgjedhje kandidatët që kanë mbaruar arsimin e mesëm dhe të lartë përpara vitit 2006 dhe kërkojnë të vazhdojnë studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në formën e studimit me kohë të pjesshme.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.165, datë 11.2.2009

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.335, DATË 2.9.1997 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR LËSHIMIN E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8668, datë 23.11.2000 “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.335, datë 2.9.1997 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa:

- a) Në pikën 3 të shtohet emërtimi:
“- Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.”.
- b) Në pikën 4 të shtohen emërtimet:
“- Inspektor i Lartë i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive;
- Ndihmësinsektor i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive;
- Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse, në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive;
- Drejtor i Marrëdhënieve me Autoritetet Përgjegjëse, me Publikun dhe Administrimin e Deklaratave, në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive;
- Këshilltar për marrëdhëniet me jashtë, në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive;
- Kryetari i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare;
- Kryetari i Komitetit Shtetëror për Kultet.”.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 9.3.2009
Doli nga shtypi më 10.3.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 32 lekë